



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.10.2018, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.

Shqyrtimi i Dekretit të Presidentit nr. 10908, dt. 11.10.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018, datë 20.09.2018 "Për përcaktimin e procedures së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar". (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Besoj se jeni njohur me axhendën e kësaj jave.

Sot do të diskutojmë Dekretin e Presidentit nr. 10908, dt. 11.10.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018, datë 20.09.2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar".

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë Dekret në cilësinë e komisionit përgjegjës që ka shqyrtuar fillimisht projektligjin, sipas përcaktimeve të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit. Relator është zoti Beqaj.

Sipas nenit 86, Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij.

Në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar, a ka ndonjë koment apo sugjerim?

Miratohet procesverbali.

Atëherë, para se të kalojmë te Dekreti "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018, datë 20.09.2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar".

Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Mirëdita të nderuar kolegë deputetë,

Në radhë të parë dua të ngre çështjen e kushtetueshmërisë së këtij dekreti të Presidentit, referuar përcaktimeve të nenit 85, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe dua të shtoj këtu faktin se Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin është shprehur njëherë lidhur me arsyet e kthimit të ligjit 37/2018 gjatë shqyrtimit të dekretit nr. 10849, datë 27.7.2018, duke bërë dhe reflektuar edhe ndryshimet përkatëse në ligj.

Prandaj, i propozoj komisionit t'i rekomandojmë seancës rrëzimin e Dekretit nr. 10908, dt. 11.10.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018, datë 20.09.2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar".

Eduard Shalsi – Atëherë, vazhdojmë. Jemi dakord me rekomandimin për rrëzimin e Dekretit nr. 10908, dt. 11.10.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018, datë 20.09.2018 "Për përcaktimin e procedures së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar"? Kundër? Abstenim? Pro?

Nuk ka.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA